



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Xhelal Sveçla, Ministër

Adresa: Rr. Luan Haradinaj, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) nga buxheti i ndarë (179,424€) për shtesa për zjarrfikës nga kategoria paga dhe mëditje kishte bërë kompensimin e të gjithë stafit në mënyrë proporcionale përfshirë edhe stafin që nuk janë zjarrfikës. Vlera e paguar për stafin që nuk janë zjarrfikës ishte 107,856€.
- B1 Detyrimet Kontingjente të shpalosura në nenin 18 të Raportit Vjetor Financiar nuk ishin të sakta.
- A2 Vlera e pasurive kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në nenin 19.3.1 të Raportit Vjetor Financiar nuk ishte e plotë dhe e saktë.
- A3 Dy projekte “Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP-it” në vlerë 1,681,074€ dhe projekti “Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës faza III” në vlerë 7,297,021€ nuk ishin regjistruar saktë sipas kërkesave të rregullores së pasurisë.
- C1 Vlera e pasurive jo kapitale nën 1,000€ e prezantuar në nenin 19.3.2 të Raportit Vjetor Financiar nuk ishte e plotë dhe e saktë.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A4 Në AKSP, gjatë vitit 2020 me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm ishin bërë kompensime të parregullta për Sekretarinë e Bordit në vlerë 2,640€.
- A5 Ishte bërë emërimi i menaxherëve të kontratës jo në pajtim me kërkesat ligjore.
- A6 Kishte mangësi në zhvillimin e procedurës së prokurimit për kontratën "Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe Pastrimit në AKSP"
- B2 Ishin bërë pagesa të parregullta në vlerë 100,583€, për të punësuarit me Marrëveshje të Brukselit.
- B3 AKSP për kontratën: "Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së kishte bërë tejkalimin e kontratës publike kornizë në vlerë prej 329,016€.
- A7 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kishte bërë pagesa pa kontratë por vetëm me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm në vlerë prej 50,042€ për shërbimet-telefonike, mobile, internet, internet për GRPS, kabull Optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet TV-kabllloreve.
- A8 AKSP nga kategoria mallra dhe shërbime kishte paguar shujta ditore për të gjithë stafin jo në pajtim me kërkesat e Ligjit Nr. 07/L001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikë së Kosovës për vitin 2020.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Mostrat e përzgjedhura të shpenzimeve të Ministria e Punëve të Brendshme në vlerë 3,866,354€, nuk i kemi audituar sepse këto shpenzime ndërlidhen me informata (dokumente) të klasifikuara.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MPB-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme .

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Kompensim i parregullt i stafit të AME-së për punë jashtë orarit, ndërrimeve të natës dhe festave

Gjetja

Me Ligjin 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti i ndarë për kategorinë paga dhe mëditje për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent ishte 1,426,442€. Në kuadër të këtij buxheti ishin përfshirë mjetet në vlerë 179,424€, për kompensimin e orëve shtesë, ndërrimeve të natës dhe festave për vitin 2019. Në bazë të korrespondencave me Thesarin këto mjete ishin dedikuar për zjarrfikësit.

Mjetet në vlerë 179,424€, të ndara me buxhet për zjarrfikësit për pagesën e orëve shtesë, ndërrimeve të natës dhe festave, ishin shpërndarë me aprovim të Drejtorit të AME-së dhe ZKF-së në mënyrë proporcionale për të gjithë stafin e AME-së (71 zjarrfikës dhe 107 staf tjetër). Si rrjedhojë i gjithë stafi kishte përfituar kompensim në vlerë 960€ (bruto) në pagën e muajit mars të vitit 2020. Shuma e kompensimit për stafin që nuk janë zjarrfikës përfshirë edhe kontributin e punëdhënësit ishte 107,856€. Për këtë vlerë nuk është ofruar ndonjë dëshmi që e arsyeton shpenzimin e ndodhur për mbajtjen e orëve shtesë, punën në ndërrimin e natës apo punën gjatë festave.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të pa mjaftueshme për ta shpenzuar buxhetin e ndarë në përputhje me qëllimin e dedikuar.

Ndikimi

Devijimi i shpenzimeve nga qëllimi i dedikuar ka ndikuar në shpenzimin jo racional të buxhetit.

Rekomandimi A1

Ministri dhe Drejtori i AME-së duhet të marrin masa për të siguruar kthimin e mjeteve të paguara për stafin që nuk janë zjarrfikës dhe të sigurojë që mos të ndodhin në të ardhmen pagesa që nuk janë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Detyrimet kontingjente (6,918,708€) të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2020, nuk ishin të sakta për shkak se vlera financiare 789,179€, e shpalosur si detyrim kontingjent, nuk ishte e mbështetur me dëshmi. Më tutje, një padi e cila ishte bërë në vlerë 100€, në listën e detyrimeve kontingjente dhe PFV ishte raportuar në vlerë 100,000€ dhe në rastin tjetër padia në vlerë 37,967€, në listën e detyrimeve kontingjente dhe PFV ishte raportuar në vlerë 379,678€.

Paraqitja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe nga pa mjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm gjatë procedimit të lëndëve për raportim të detyrimeve kontingjente në PFV.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi B1 Ministri në bashkëpunim me drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojë që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Regjistri jo i plotë i pasurive kapitale

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Vlera e pasurisë (112,904,929€) e prezantuar në nenin 19.3.1 pasurisë kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk ishte e plotë dhe e saktë për shkak se: Projekti për zgjerimin e ngrahjes në shumë 114,503€ në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ishte regjistruar dy herë në regjistrin e pasurisë. Po ashtu, ndërtesat e AKSP-së (konvikti për meshkuj, konvikti për femra, salla e sportit, objekti i ngrahjes) nuk janë të raportuara si pasuri në regjistrin e pasurisë edhe pse ato objekte janë duke u përdorur nga AKSP.

Më tutje, në Policinë e Kosovës kemi identifikuar që në regjistrin e pasurisë nuk ishte i regjistruar agregati ftohës- chiller me kapacitet Qft=195W deri 200,4KW komplet me pompë, amortizator të gypave me të gjitha pajisjet përcjellëse. Kjo pasuri edhe pse ishte pranuar nga komisioni me datën 08.07.2020 nuk ishte e regjistruar në regjistrin e pasurisë mbi 1,000€. Vlera financiare e pasurisë ishte 35,462€.

Shkaku i mos raportimit të pasurive në PFV ishte se ato objekte ishin të trashëguara dhe nuk kishin të caktuar ndonjë vlerë financiar, ndërsa mos azhurnimi i regjistrit të pasurive ishte si rezultat i mungesës së vëmendjes gjatë operimit të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrin përkatës ka ndikuar që vlera e pasurive kapitale e raportuar në PFV të mos jetë e plotë dhe kjo ndikon që informatat të jenë çorientuese për përdoruesit e PFV-ve.

Rekomandimi A2 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe objektet të cilat nuk janë të regjistruara të regjistrohen sipas kërkesave të rregullores në mënyrë që vlera e pasurive në PFV të jetë e plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Dobësi në menaxhim të pasurisë

Gjetja Neni 10 i Rregullores 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare thekson "Të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimet në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe i vlerësimit". Neni 11.3 i kësaj rregullore thekson "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Neni 13 Blerja dhe ndërtimi i pasurisë jo-financiare për organizatat tjera buxhetore, thekson "Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim". Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj".

Projekti "Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP-it" me vlerë 1,681,074€ (kontrata bazë 1,643,051€ e lidhur në vitin 2016 dhe aneks kontrata 38,022€ e lidhur në vitin 2017) ishte pranuar nga Komisioni i pranimet teknik me datë 13.03.2020. Në regjistrin e pasurisë ky projekt ende mbahej i regjistruar si investim në vijim në vlerë 1,662,938€ dhe jo si pasuri në përdorim. Si rrjedhojë e kësaj Ministria ende nuk kishte filluar të aplikoj zhvlerësimin edhe pse objekti ishte funksional dhe në përdorim.

Projekti "Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës faza III" me vlerë të kontratës 7,297,021€ kishte përfunduar me 10.12.2020 duke u bazuar në raportin e inspektimit final të kryer nga Komisioni i inspektimit i cili e cilëson objektin në funksion të plotë. Objekti ende nuk i kishte kaluar rregullat dhe procedurat e dorëzimit tek OB që është përfituese e projektit (Universiteti i Mitrovicës) dhe si rrjedhojë mbahet në regjistrin e pasurisë së MPB-së si investim në vijim. Ne kemi testuar pagesën në vlerë 689,581€.

Kjo kishte ardhur si rezultat i mungesës së koordinimit të mjaftueshëm në mes të zyrtarëve përgjegjës për projektet.

Ndikimi Mbajtja e projekteve të përfunduara si investime në vijim ndikon që vlera e pasurisë e shpalosur në pasqyra financiare të jetë e mbivlerësuar.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë që regjistri i pasurisë të azhurnohet në vazhdimësi në raport me projektet e përfunduara duke i respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Regjistri jo i plotë dhe i saktë i pasurive jo kapitale****Gjetja**

Neni 6 “Rregullores MF - Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore” paragrafi 2 përcakton se: Regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale (vlera individuale mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit), pasuritë jo kapitale (vlera individuale më e vogël se 1,000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit) dhe stoqet.

Vlera e pasurisë (3,743,869€) e prezantuar në nenin 19.3.2 për pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€ nuk ishte e plotë dhe e saktë për shkak se:

- Në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) kemi identifikuar që në regjistrin e pasurive nuk ishin regjistruar 26 kompjuterë në vlerë 11,804€;
- Në MPB kemi vërejtur që 150 shtretër metali në vlerë 17,250€ dhe 150 dyshekë ortopedik në vlerë 7,500€, figurojnë të regjistruar më shumë se një herë në regjistrin e pasurisë nën 1,000€. Si rrjedhojë vlera neto e shtretërve metalik ishte mbivlerësuar për 41,560€ ndërsa vlera neto e dyshekëve ortopedik ishte mbivlerësuar për 18,108€.
- Në AKSP kemi identifikuar se pasurisë nën 1,000€ të blerë në vitin 2020 nuk i është llogaritur zhvlerësimi sipas kërkesave të rregullores së pasurive dhe si rrjedhojë, pasuritë ishin mbivlerësuar për 588€. Më tutje kemi vërejtur se në regjistrin e pasurisë nën 1,000€ janë të regjistruara pasuritë nga dy herë (3 raste).

Shkaku i mbivlerësimit/nënvlerësimit të pasurisë nën 1,000€ dhe mos zhvlerësimi i tyre kishte ardhur si rezultat i problemeve të sistemit e-pasuria, ku me rastin e bartjes së të dhënave nga softueri paraprak në softuerin e ri një pjesë e artikujve ishin shumëfishuar.

Ndikimi

Mos azhurnimi i regjistrin të pasurive ndikon që vlera e pasurive të mos jetë e plotë dhe kjo rrit rrezikun e shpalosjes së informatave çorientuese për shfrytëzuesit e PFV.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të merr masa që në koordinim me akterët përgjegjës të zgjidhen problemet me sistemin E-pasuria në mënyrë që gjendja e pasurisë jo-kapitale të entitetit të prezantohet saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Kompensim i parregullt për Sekretarinë e Bordit të AKSP-së

Gjetja

Neni 12 i Rregullores nr.06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike” përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Sekretarisë së Bordit dhe nuk parasheh kompensime për këto shërbime.

Me Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së ishte caktuar sekretaria e bordit që përbëhet nga zyrtarët të AKSP-së (anëtarët e caktuar në sekretari të bordit ishin staf i rregullt me kontratë në AKSP). Po ashtu me këtë vendim ishin përcaktuar kompensimet në baza mujore, 100€ për kryesuesin dhe nga 70€ për dy anëtarët. Këto kompensime nuk ishin në pajtim me “Rregulloren nr.06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike” e cila nuk parasheh kompensim për shërbime të tilla. Vlen të theksohet se me datën 03.12.2020, AKSP kishte shfuqizuar vendimin që kishte përcaktuar kompensimet e tilla. Vlen të theksohet se me datën 03.12.2020, AKSP kishte shfuqizuar vendimin që kishte përcaktuar kompensimet e tilla.

Kompensimet për Sekretarinë e Bordit kanë ndodhur për shkak të pa kujdesisë së Autoritetit Kontraktues në marrjen e vendimeve për kompensime të tilla.

Ndikimi

Kompensimet e tilla ndikojnë në rritjen e shpenzimeve të pa arsyeshme dhe në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi A4

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të ndërmarrin masa në kthimin e mjeteve për kompensime të pa rregullta dhe të sigurojë që në të ardhmen kompensimet e Sekretarisë së Bordit të AKSP-së të bëhen vetëm mbi bazën e legjislacionit në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Emërimi i menaxherit të kontratës jo në pajtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Neni 62.3.7 i Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (UOPP), përcakton: “Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i Projektit”.

Ne kemi identifikuar që menaxherë të kontratave ishin caktuar të njëjtit zyrtarë që kishin qenë edhe në komisionin e vlerësimit të ofertave. Kjo dukuri nuk është në pajtim me kërkesat e UOPP. Këto dobësi i kemi identifikuar në këto projekte:

- "Furnizim me Aparate të Frymëmarrjes dhe bombola të ajrit" në (AME) në vlerë prej 559,202€;
- "Furnizim Emergjent me Dezinfektues për duar" në (PK) në vlerë prej 15,600€; dhe
- “Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes, ftohjes, klimatizimit dhe të makinave të lavandarisë” në (AKSP) në vlerë prej 24,888€.

Emërimi i menaxherit të projektit jo në pajtim me kërkesat ligjore ishte rezultat i kontrolleve jo të mjaftueshme të shkaktuara nga menaxhmenti.

Ndikimi Emërimi i anëtarit të komisionit vlerësues edhe në pozitën e menaxherit të kontratës, ndikon në ndarjen jo të mirë të detyrave dhe përgjegjësive dhe mund të ndikojë në konfliktin e mundshëm të interesit.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj që të ketë ndarje adekuate të detyrave në rastet e emërimit të menaxherëve të kontratës në mënyrë që të parandalohet konflikti i interesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Dobësi në procedurën e prokurimit

Gjetja Neni 38 paragrafi 2 i Ligjit të Prokurimit Publik përcakton se " Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se 36 muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedura të reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohë zgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Më tutje, neni 61.4 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik përcakton "Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ "ZKA" dhe ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Projektit përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike dhe për ta informuar Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit".

Në procedurën e negociuar të prokurimit "Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe Pastrimit në AKSP" kemi vërejtur se AKSP me 13.01.2020 kishte lidhur kontratë publike kornizë duke mos e përcaktuar afatin kohor të kontratës. Po ashtu, kemi vërejtur se në dosjen e tenderit vlera e parashikuar e kontratës publike kornizë ishte 50,000€ ndërsa kontrata ishte lidhur në vlerë 14,455€ për shërbime mujore. Më tutje, AKSP nuk kishte caktuar menaxher të kontratës si dhe nuk kishte përgatit plan të menaxhimit të kontratës. Deri në fund të vitit 2020 me këtë kontratë ishin paguar 159,005€, shërbime për mirëmbajtje dhe pastrim.

Mos përcaktimi i afatit kohor të kontratës kishte ndodhur për shkak se AKSP procedurën e rregullt të prokurimit e kishte në proces të ankesave në OSHP ndërsa mos emërimi i Menaxherit të Projektit ishte si rezultat i mos kujdesit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.

Ndikimi Mos përcaktimi i afatit kohor në kontratë dhe mungesa e emërimit të menaxherit të kontratës përveç që është në kundërshtim me kërkesat ligjore, mund të ndikoj që AKSP të bëjë furnizime më shumë se sa vlera e parashikuar e kontratës.

Rekomandimi A6 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së të siguroj që në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktohen afatet kohore të kontratave si dhe kontratat publike kornizë të mos tejkalojnë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë**Gjetja**

Sipas vendimit nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Ish MAP ka qenë e obliguar t'i sistemoj 20 punëtorë të komunitetit serb. Zyrtarët e lartcekur, në vitin 2020, nuk ishin paraqitur në vendin e punës, përderisa ministria kishte bërë pagesën e pagave të tyre në vlerë totale 100,583€.

Shkaku i mos paraqitjes në punë të këtyre zyrtarëve ishte mos krijimi i kushteve të duhura për punë, kontrolli i dobët dhe mos monitorimi i tyre nga menaxhmenti i ministrisë.

Ndikimi

Pagesa e pagave pa vijueshmëri në punë shkakton dëmtim të buxhetit dhe njëkohësisht ndikon në mosarritjen e objektivave të përcaktuara me marrëveshje.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar krijimin e kushteve për vijueshmërinë e rregullt në punë të komunitetit serb, kompensimin e tyre me pagë vetëm pas paraqitjes së rregullt në punë duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet nënligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Tejkalmi i vlerës së kontratës kornizë****Gjetja**

Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/ L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, neni 22 parasheh: “Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%) pa marrë parasysh datën origjinale të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht”.

AKSP me 13.06.2019, kishte lidhur kontratën publike kornizë (me një operator ekonomik, procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë) “Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së “. Vlera totale indikative e kontratës publike kornizë ishte 206,394€. Ne kemi identifikuar se AKSP gjatë periudhës 2019-2020 kishte bërë pagesa në vlerë 660,328€, duke bërë tejkalimin e vlerës së kontratës për 392,016€, mbi normën e lejuar 30%. Vlera totale indikative e kontratës 206,394€, plus 30% (61,919€), gjithsej shuma e lejuar për pagesë 268,312€.

Tejkalimi i kontratës kishte ndodhur për shkak se procedura e rregullt e prokurimit ishte në proces të ankesave në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

- Ndikimi** Tejkalimi i kontratës kornizë mbi normën e lejuar, ndikon që organizata buxhetore (OB) të hyj në obligime të pa planifikuara dhe rrjedhimisht ndikon që të bëhen shpenzime jo në pajtim me kornizën ligjore.
- Rekomandimi B3** Ministri duhet të sigurojë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkualuar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Paguesa e bërë pas përfundimit të afatit të kontratës

- Gjetja** Kontrata për "Shërbimet - telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kabulli Optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet TV - Kabllorik", neni 1,4 përcakton se kontrata publike kornizë kishte afat prej 36 muajve, duke filluar prej 01.04.2017 e deri me 31.03.2020.

Gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar që me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm ishin bërë dy pagesa në vlerë prej 50,042€ për Telekomin e Kosovës për shkak se kishte skaduar kontrata.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike pas përfundimit të kontratës i kishte propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës që procedura e prokurimit për shërbime të telekomunikimit të përjashtohet nga LPP. Me datën 02.04.2020 Qeveria e Republikës së Kosovës, kishte miratuar propozimin e ministrisë përmes Vendimit nr.05/21, me të cilën kishte përjashtuar nga fushëveprimi i Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, shërbimet e telekomunikimit që ofron Telekom i Kosovës SH.A, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore.

Pas përjashtimit të procedurës nga procesi i prokurimit, Drejtori i Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit (ASHI)-MPB me datë 08.04.2020 kishte themeluar komisionin ndërinstitucional për negociimin e kushteve të Kontratës për shërbimet telekomunikuese që ofron Telekom i Kosovës SH.A. të cilat shfrytëzohen nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të nivelit qendror e lokal.

Komisioni me datën 27.05.2020 kishte përgatitur raportin e punës dhe në koordinim me Telekomin e Kosovës kishte hartuar draft-kontratën finale për nënshkrim. Edhe pse komisioni e kishte përfunduar punën, MPB nuk kishte nënshkruar kontratën dhe kishte vazhduar pagesat përmes vendimeve me modul të aprovimit. Ne kemi kërkuar sqarime se pse nuk është bërë nënshkrimi i kontratës për shërbime e telekomunikimit por MPB nuk ka ofruar ndonjë sqarim konkret përveç asaj që është përshkruar më lartë.

Më pas, me ndryshimin e Qeverisë, Kryeministri me 07.10.2020 nxjerr vendim me Nr. 05/34 ku i shfuqizon disa vendime duke përfshirë edhe Vendimin Nr. 05/21 të datës 02.04.2020. Sipas këtij vendimi " Obligohen të gjitha institucionet/ organizatat buxhetore që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e përcaktuara me Ligj dhe të mos kryejnë procedura të prokurimit sipas nenit 3 të Ligjit për Prokurim Publik pa vendim të Qeverisë".

Kështu që nga data e këtij vendimi ministria nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për zhvillimin e procedurave të prokurimit për ta zgjidhur këtë situatë me të cilën po ballafaqohen shumica e Organizatave Buxhetore.

Ndikimi

Mos zgjidhja e kësaj situatë të krijuar po ndikon që të pranohen shërbime nga Telekom i Kosovës pa kontratë dhe të cilat janë duke u paguar nga Organizatat Buxhetore.

Rekomandimi A7

Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në këtë proces duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar zgjidhjen e kësaj situatë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Pagesa për shujta për stafin e AKSP-së

Gjetja Neni 12 paragrafi 6 i Ligjit Nr. 07/L001 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, parasheh që "Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës".

Nga testimi i 12 mostrave për furnizim me ushqim dhe pije në vlerë prej 296,328€, kemi vërejtur se AKSP me vendim të datës 31.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, kishte paguar 39,454€, shujta për ushqim për stafin e saj, përkundër faktit që këto pagesa nuk janë të lejuara sipas Ligjit për Ndarje Buxhetore nga kategoria mallra dhe shërbime.

Ndikimi Pagesat e tilla jo në pajtim me ligjin nga kategoria mallra dhe shërbime kanë ndikuar në shpenzim jo racional të buxhetit.

Rekomandimi A8 Ministri, respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të rishikojnë vendimin për shujta ditore dhe të ndërmarrin masa për ndalimin e tyre nga kategoria mallra dhe shërbime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga dhe Mëditje ishte 103,873,573€, prej tyre ishin shpenzuar 103,865,391€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 11,060 punonjës ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 10,685 punonjës. Gjatë auditimit kemi testuar 154 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 209,425€ dhe janë identifikuar dobësi të cilat janë shpalosur në vijim:

Çështja C2 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara

Gjetja

Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 02/2018 për rregullimin e marrëdhënies së punës në Policinë e Kosovës (PK), përkatësisht neni 39 paragrafi 3 përcakton se: me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë secili zyrtar i Policisë mund të caktohet në një vend të punës apo transferohet prej një vendi në vendin tjetër të punës nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për atë vend të punës, pa marrë parasysh nivelin, pozitën apo gradën. Udhëzimi Administrativ nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor përcakton kriteret që duhet t'i plotësoj secili Zyrtari Policor për pjesëmarrje në gradim dhe procesin e testimit që duhet t'i nënshtrohet për të marrë gradën e caktuar. Struktura organizative e Policisë së Kosovës përcakton gradën e kërkuar për secilën pozitë të punës.

Një numër i stafit policor ende është sistemuar në pozita të punës pa e plotësuar kriterin e gradës që e kërkon ajo pozitë sipas strukturës organizative. Sipas të dhënave nga njësia e personelit, 168 zyrtarë policor vazhdojnë të mbeten të sistemuar në pozita ku kërkohet gradë më e lartë se sa grada që aktualisht e kishin arritur të punësuarit përmes procesit të rregullt të gradimit. Vlen të theksohet se PK, kishte kryer disa procese të gradimit për reduktim të numrit të punësuarve që ushtrojnë pozita me grada më të larta por deri më tani këto procese janë të pamjaftueshme për respektimin e plotë të kriterëve të sistematizimit në vendet e punës sipas gradës përkatëse. Pra, në raport me vitin paraprak është zvogëluar nga 198 në 168.

Ndikimi

Sistemimi i stafit në pozita që nuk janë në përputhje me gradën adekuate mund të ndikoj që pozitat e punës të ushtrohen nga persona me mungesë të kompetencës profesionale.

Rekomandimi C2

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PKsë duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe procesi i gradimit të zhvillohet duke iu përgjigjur nevojave të PK-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 34,029,262€, prej tyre ishin shpenzuar 27,335,202€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e derivateve të naftës, furnizime me material zyrtar, furnizime tjera për nevoja të ministrisë. Gjatë auditimit kemi testuar 76 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 5,800,903€ dhe kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja A9 - Mos-njoftim i KRPP-së për refuzim të tenderit me çmim jo normalisht të ulët

Gjetja

Neni 61 i Ligjit për Prokurim Publik (me ndryshime dhe plotësime) "Tenderët jo normalisht të ulët" përkatësisht paragrafi 4 thekson "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin, ndërsa paragrafi 5 thekson "Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi sipas paragrafit 4 të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen".

Në procedurën e tenderimit "Mirëmbajtje e sistemit të ngrohjes, ftohjes dhe makinave të lavandarisë" në AKSP, kontrata ishte lidhur në vlerë 24,888€ ndërsa oferta më e lirë ishte në vlerë 12,894€. Kjo ofertë ishte vlerësuar si jo e përgjegjshme nga Komisioni i Vlerësimit për shkak të çmimit jo normalisht të ulët të ofertuar. AK kishte kërkuar sqarime nga ofertuesi për çmimet jo-normalisht të ulëta dhe pas arsyetimit të dhënë, AK nuk ishte bindur dhe e kishte refuzuar tenderin si të papërgjegjshëm. Lidhur me këtë vendim AK nuk e ka njoftuar KRPP-në ashtu siç është i obliguar me nenin 61.5 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Mos njoftimi i KRPP-së për refuzimin e tenderit me çmim jo normalisht të ulët ishte shkaktuar nga mungesa e vëmendjes së duhur nga zyra e prokurimit.

Ndikimi

Mos-njoftimi i KRPP-së për refuzim të tenderit me çmim jo normalisht të ulët përveç që është shkelje ligjore ndikon edhe në mungesën e transparencës së procesit.

Rekomandimi A9

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të sigurojnë përbushjen e kërkesave ligjore në raport me KRPP-në duke e njoftuar atë në të gjitha rastet kur kjo kërkesë është obligative.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 21,200,051€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 17,833,923€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe renovimin e objekteve, blerjen e automjeteve për zjarrfikës, shpenzime për projektin platforma e interoperabilitetit etj. Gjatë auditimit kemi testuar 36 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 5,068,740€, dhe kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja A10 - Mos-realizim i projektit brenda afatit kohor

Gjetja

Neni 6.4 i Kushteve të veçanta të Kontrates “Studimi i fizibilitetit për Spitalin e Prishtinës” përcakton se projekti duhet të përfundoj për periudhë gjashtë mujore.

Ministria e Administratës Publike (MAP) me datë 24.09.2019 kishte lidhur kontratë me OE për “Studimin e fizibilitetit për Spitalin e Prishtinës” në vlerë prej 650,000€ me kohëzgjatje gjashtë mujore. Në kontratë ishin paraparë dy pozicione:” Kryerja e fizibilitetit të Spitalit të Prishtinës” dhe “Hartimi i projektit detal (zbatues)”. Ne kemi identifikuar se projekti nuk kishte arritur të realizohet brenda afatit të paraparë me kontratë. Në mars të vitit 2020 OE kishte dorëzuar në Ministri, Draft Studimin e Fisibilitetit për komente, por nuk kishte pranuar përgjigje nga palët e interesit të përfshira në këtë projekt (MAP, Ministri i Shëndetësisë (MSH) dhe Komuna e Prishtinës).

MPB më datë 24.08.2020 kishte paguar shumën financiare 182,000€ për draftin e përfunduar të fizibilitetit. Sipas komunikimeve të Menaxherit të projektit me palët e interesit, ne kemi vërejtur që projekti kishte ngecur dhe nuk kishte pasur asnjë zhvillim pas pranimin të draftit të fizibilitetit.

Shkak i mos-realizimit të projektit brenda afatit të paraparë kohor është rezultat i planifikimit jo të mirë nga Ministria. Për më tepër bazuar në komunikimet në mes Ministrisë dhe OE shihet se OE kishte shprehur gatishmëri të vazhdueshme për zhvillim të projektit por këto kërkesa ishin neglizhuar nga akterët e përfshirë në projekt.

Ndikimi

Mos-përmbushja e kontratës brenda afatit të paraparë kohor është rezultat i planifikimit jo të mirë dhe kjo ka ndikuar që projekti për ndërtim të Spitalit të Prishtinës të mos hartohet. Rrjedhimisht mungesa e projektit e pa mundëson edhe ndërtimin e Spitalit.

Rekomandimi A10

Ministri duhet të ndërmerr masa konkrete përmes të cilave siguron realizimin e projektit për Spitalin e Prishtinës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

MPB në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 10,675,088€. Kjo vlerë përbëhet nga gjobat e trafikut dhe nga punët sekondare që ofrohen nga Policia e Kosovës në ofrimin e shërbimeve të sigurimit për objekte publike. Kemi testuar 19 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 39,903€, dhe kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja B4 - Regjistrim dhe raportim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme (LLA)

Gjetja Neni 16 i Raportit Vjetor Financiar kërkon që llogaritë e arkëtueshme të prezantohen drejtë dhe saktë.

Ne kemi identifikuar se në 5 raste Policia e Kosovës në pajtim me ligjet në fuqi kishte lëshuar fletëparaqitje për kundërvajtje (pa e precizuar vlerën financiare të gjobës) duke i proceduar lëndët në Gjykatë. Për këto 5 raste sistemi informativ i policisë kishte përlllogaritur vlerën financiare në shumë 6,200€, të cilat ishin të raportuara edhe në RVF. Këto gjoba nuk është dashur të raportohen në RVF si llogari të arkëtueshme pasi kanë kaluar nën menaxhimin e gjykatave. Sipas zyrtarëve shkak i ndodhjes së kësaj dukurie është se në momentin e lëshimit të tiketës nga policia për gjykatë sistemi në mënyrë automatike e llogaritë shumën financiare.

Për më shumë, kemi identifikuar 2 raste ku vlerat e gjobave të shqiptuara ishin 70€ (gjoba 35€, dhe gjoba 35€), ndërsa në regjistrin e llogarive të arkëtueshme këto gjoba ishin raportuar si llogari e arkëtueshme në shumë 8,000€ (6,000€ dhe 2,000€). Kjo ka ardhur si pasojë e futjes së gabueshme të informatave në sistemin elektronik.

Në një rast kemi vërejtur se fatura në vlerë 2,791€ është lëshuar më 25.01.2021 dhe është raportuar si llogari e arkëtueshme në RVF-të e vitit 2020. Kjo lëndë i referohet sigurimit të objektit që është bërë për muajin dhjetor 2020.

Kjo ka ardhur si pasojë e futjes së gabueshme të informatave në sistemin elektronik si dhe mungesës së vëmendjes nga personat përgjegjës për regjistrim dhe raportim të shpalosjeve.

Ndikimi Regjistrimi në sistem i fletëparaqitjeve të cilat kanë kaluar në gjykata si dhe gabimet e bëra në regjistrimin e llogarive të arkëtueshme kanë ndikuar që LLA të mos jenë të sakta dhe të njëjtat të japin informata çorientuese në RVF.

Rekomandimi B4 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që LI/A të prezantohen drejtë në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	160,181,852.00	160,959,976.82	150,311,343.47	128,689,456.17	113,198,085.06
Grante Qeveritare - Buxheti	152,935,723.00	153,830,181.72	145,784,719.25	118,951,965.66	112,683,569.42
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	340,749.03	23,531.06	0.00	0.00
Të hyrat vetanake	891,129.00	891,129.00	654,855.53	550,379.97	500,000.00
Te hyrat nga AKP-ja	6,355,000.00	5,868,537.00	3,830,747.94	9,185,322.74	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	29,380.07	17,489.69	1,787.80	14,515.64

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 778,125€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar 340,749€, donacioneve 29,380€ dhe rritja në vlerë 407,996€ ishte bërë me vendime të qeverisë.

Në vitin 2020 MPB kishte shpenzuar 93% të buxhetit ose 150,311,343€ dhe krahasuar me vitin 2019 shpenzimet ishin 96%. Sidoqoftë, shpenzimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	160,181,852.00	160,959,976.82	150,311,343.47	128,689,456.17	113,198,085.06
Pagat dhe mëditjet	81,270,809.00	103,873,573.27	103,865,391.31	85,542,781.70	79,388,733.74
Mallrat dhe shërbimet	34,069,273.00	30,228,286.00	23,725,758.02	23,456,349.93	22,056,241.23
Komunalitë	4,956,400.00	3,800,976.04	3,609,443.51	1,308,441.16	1,270,436.39
Subvencionet dhe transferet	2,141,367.00	1,857,090.21	1,276,827.89	950,626.83	1,989,391.93
Investimet Kapitale	37,744,003.00	21,200,051.30	17,833,922.74	17,431,256.55	8,493,281.77

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 22,602,765€. Rritja ishte bërë me rishikim të buxhetit në shumë 5,796,850€ si dhe me vendime të qeverisë për ndarje dhe kursime, buxheti ishte rritur për 16,805,915€. Ky ndryshim i buxhetit final krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë paga dhe mëditje ishte si rezultat i planifikimit jo të mirë të buxhetit.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 3,840,987€. Fillimisht, me rishikim të buxhetit mallrat dhe shërbimet ishin zvogëluar për 2,725,000€, ndërsa më pas, me vendime të qeverisë ishin bërë kursime buxhetore në vlerë 3,249,553€. Me vendim të qeverisë për ndarje buxhetore kjo kategori më vonë ishte rritur në shumë 2,133,566€.


Buxheti final për komunalitet ishte zvogëluar për 1,155,422€. Me rishikim të buxhetit ishin bërë kursime buxhetore në shumë 733,185€ dhe me vendime të qeverisë buxheti ishte zvogëluar në shumë 422,237€.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 284,277€. Zvogëlimet ishin bërë me vendime të qeverisë për kursime buxhetore dhe ndarje buxhetore.


Buxheti final për investime kapitale ishte zvogëluar për 16,543,952€. Zvogëlimi në shumë 13,698,260€ për kursime buxhetore kishte ndodhur si rezultat i rishikimit të buxhetit. Ndërsa, përmes vendimeve të qeverisë për kursime dhe ndarje buxhetore buxheti ishte zvogëluar edhe për 2,845,692€. Përkundër zvogëlimit të buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 84 % e buxhetit për investime kapitale ishte shpenzuar.

Për më shumë, shpenzimet për menaxhimin e pandemisë COVID '19 për vitin 2020 ishin 8,243,807€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shtesat në paga për Policinë e Kosovës në shumë 8,097,788€ dhe shpenzimet tjera në shumë 146,019€ kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime që ndërlidhen kryesisht me furnizime me pajisje mbrojtëse (si maska, dorëza, dezinfektues etj). Ne kemi testuar gjithsej 20 mostra në vlerë 116,946€ dhe nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për tu raportuar.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Buxheti final për të hyrat krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 11,292,948€. Ky ndryshim ishte bërë me rishikime buxhetore. MPB për vitin 2020 kishte realizuar të hyra në vlerë prej 52,209,533€. Të hyrat e realizuara rrjedhin nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksa për dokumente të udhëtimit, gjoba në trafik dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	67,225,003.00	55,932,055.00	52,209,533.02	62,209,192.34	55,920,802.49
Të hyrat jo tatimore	67,225,003.00	55,932,055.00	52,209,533.02	62,209,192.34	55,919,738.49
Të hyrat tjera	0.00	0.00			1,064.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Rregullorja (QRK) - Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive parasheh se në kuadër të MPB-së është integruar Ministria e Administratës Publike (MAP). Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 kishte rezultuar me 27 rekomandime (14 rekomandime ishin për MPB dhe 13 rekomandime për MAP). MPB kishte përgatitur Planin e Veprimit si dhe raportin e progresit për zbatim të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, 15 rekomandime ishin zbatuar; 2 rekomandime ishin pjesërisht të zbatuara; 4 rekomandime nuk ka filluar zbatimin i tyre ndërsa 6 rekomandime ishin të mbyllura të pa zbatuara (nuk aplikohen më), siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur ceket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit - deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Detyrimet	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të plota dhe të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Gjatë vitit 2020 kemi vërejtur se ende ka probleme të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim i pa zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Detyrimet	Ministri duhet të siguroj që për detyrimet kontingjente të bëhet një vlerësim i rrezikut me qëllim të planifikimit më të mirë financiar dhe daljes së mundshme të parasë gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të mos rrezikohen aktivitetet e përditshme të ministrisë nga aktgjykimet e papritura gjyqësore.	Për shkak se MAP ishte integruar në kuadër të MPB-së, ne konsiderojmë si rekomandim të mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri të siguroj se do ta caktoj një zyrtar përgjegjës ashtu siç kërkohet me rregullore dhe do të hartoj raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Pas hartimit të këtyre raporteve t'i dërgoj në ZKA dhe Kuvend.	Ministria kishte përgatit raportin për zbatim të rekomandimeve dhe e konsiderojmë si rekomandim të zbatuar.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar ndonjë veprim konkret lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pagat dhe mëditjet	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së duhet të siguroj se çdo pozitë e shpallur për rekrutim është në përputhje me katalogun e pozitave të punës të aprovuar nga MAP. Po ashtu të siguroj se komisioni përzgjedhës me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të punësimit të hartoj dokumentet siç kërkohet me rregullativën ligjore që të sigurohet punësim në bazë të meritës dhe nevojave të punës.	Pasiqë në vitin 2020 nuk kishte procese të rekrutimit, ne e konsiderojmë si rekomandim të mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Pagat dhe mëditjet	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së të siguroj se në të ardhmen komisioni përzgjedhës i rekrutimit do të respektoj kërkesat e akteve që e rregullojnë themelimin e marrëdhënies së punës dhe kriteret e konkursit	Pasiqë në vitin 2020 nuk kishte procese të rekrutimit, ne e konsiderojmë si rekomandim të mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më

7.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.	Gjatë vitit 2020 kemi identifikuar se çështja e pozitive vazhdon të jetë e pa zgjidhur por PK ka ndërmarr disa hapa dhe numri i pozitive të tilla është më i ulët se vitin e kaluar dhe këtë rekomandim e konsiderojmë pjesërisht të zbatuar. Për më shumë afati i zbatimit të këtij rekomandimi është deri në Qershor 2021.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë, në rastet kur planifikohet të bëhet rekrutimi i kadetëve të rinj duhet të koordinohen mes veti në mënyrë që përgatitjet operative dhe ato financiare të kryhen me kohë	Çështje të natyrës së njëjtë kishte edhe në vitin 2020.	Nuk ka filluar zbatimimi
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet prezantohen saktë në pasqyrat financiare sipas të dhënave të SIMFK-së dhe kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.	Gjatë vitit 2020 të gjitha shpenzimet janë prezantuar në PFV kështu që konsiderojmë se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
10.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ta sqaroj çështjen e avanceve të hapura, të trashëguara nga vitet e mëparshme dhe të siguroj se një problem i tillë nuk do të shfaqet në të ardhmen. Për këtë qëllim duhet të ngritet një komision i përbashkët në identifikimin dhe në mbylljen e tyre	Gjatë vitit 2020 kemi identifikuar se shumica e avanceve është më e ulët krahasuar me vitin 2019 dhe nga kjo shihet se entiteti ka ndërmarr veprime duke formuar komisione për trajtimin e kësaj çështje dhe është në proces të zbatimit.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurohet që pagesat mos të kryhen para pranimit të shërbimit dhe faturës, të njëjtat të jenë në pajtim me LMFPD dhe rregullën 01/2013 të Thesarit për ekzekutimin e pagesave.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim të zbatuar.	I zbatuar

12.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim i të zbatuar.	I zbatuar
13.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të vendosë kontrolle rigorozë tek menaxhimi i avanseve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që secili shfrytëzuesi i avansit të bëjë mbylljen e tyre, siç kërkohet me procedurat e parapara me rregullat financiare	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim i të zbatuar.	I zbatuar
14.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet e brendshme, në mënyrë që në të ardhmen mos të bëhen furnizime dhe të mos të procedohen pagesa për të cilat nuk bëhen kërkesa nga ministritë të cilat janë të parapara me kontratën për furnizime me lule për ambiente të jashtme në ndërtesa.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar ndonjë çështje të tillë.	I zbatuar
15.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të siguroj që me rastin e pagesës së shpenzimeve menaxheri i kontratës dhe certifikuesi të aplikojnë kontrolle efektive në procesin shpenzimit të parasë publike për t'u siguruar se pagesat bëhen vetëm për furnizimet e realizuara në kohë dhe sipas cilësisë së përcaktuar me kontratë.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar ndonjë çështje të tillë dhe konsiderojmë që rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
16.	Subvencionet dhe transferet	Ministri të siguroj se kompensimet e stafit bëhen vetëm në rastet e parapara me ligjin e pagave dhe të ndërpres praktikën e tilla të shpërblimeve pa bazë ligjore. Për më tepër, mjetet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të ndahen sipas destinimit për të cilin janë alokuar dhe në pajtim me kërkesat ligjore.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë të zbatuar.	I zbatuar
17.	Investimet kapitale	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të buxhetit, shpenzimet të planifikohen në kategorinë adekuate ekonomike sipas planit kontabël.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë të zbatuar.	I zbatuar
18.	Investimet kapitale	Ministri, duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar ndonjë çështje të tillë.	I zbatuar


19.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave për projekte të reja ndërtimore, ti kushtohet vëmendje e shtuar specifikimit të kërkesave dhe planifikimi i objekteve të bëhet duke pasur parasysh të gjitha elementet që e përbëjnë objektin si tërësi funksionale. Kjo do të ndihmonte, që të mos ketë vonesa në implementimin e projekteve si dhe të mos shfaqet nevoja për mjete financiare shtesë.	Rekomandimi përkatës i referohet MAP-it por për shkak se MAP ishte integruar në kuadër të MPB-së, ne konsiderojmë si rekomandim të mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
20.	Çështjet e përbashkëta	Ministri të siguroj se obligimet e papaguara duhet të trajtohen me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha obligimet.	Sipas vlerësimit tonë për vitin 2020 nuk kemi identifikuar ndonjë çështje lidhur me obligimet dhe konsiderojmë që rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
21.	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim Drejtorin e AME-së përmes MAP-it të siguroj funksionalizimin dhe monitorimin e sistemit të e-pasurisë në mënyrë që të gjenerohen informata të sakta për pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet dhe të njëjtat të prezantohen në RVF.	Gjatë vitit 2020 kemi identifikuar se çështje të natyrës së tillë kishte edhe gjatë vitit dhe e konsiderojmë si rekomandim pjesërisht të zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar
22.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që anëtarët e komisionit për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë të emërohen nëpunës kompetent dhe profesional që do të mundësonin inventarizimin e plotë, në pajtim me kërkesat ligjore dhe prezantimin e saktë të pasurisë në PVF.	Entiteti ka ndermarr veprime dhe konsiderojmë që rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
23.	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AME-së duhet të sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, duke i regjistruar të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim të zbatuar.	I zbatuar
24.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që LI/A të prezantohen drejtë në RVF.	Gjatë vitit 2020 kemi vërejtur se ende ka probleme të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim të pa zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi

25.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit (përveç atyre që kanë afat) të evitohet. Po ashtu, të ketë raportim të drejtë të obligimeve në raportimet financiare.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi vërejtur çështje të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë rekomandim të zbatuar.	I zbatuar
26.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal	NJAB në raportet e tyre ka dhënë rekomandime dhe disa nga ato janë zbatuar dhe disa janë në proces. Entiteti vitin 2020 është fuzionuar me MPB prandaj rekomandimin e konsiderojmë të mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
27.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që përbërja e Komitetit të Auditimit të jetë në harmoni me kërkesat ligjore me qëllim që KA të mund të mbulojë përgjegjësitë e veta në mënyrë të pavarur.	ZKA ka ndërmarr hapa konkret dhe e ka bërë zbatimin i ketij rekomandimi	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Ministri dhe Drejtori i AME-së duhet të marrin masa për të siguruar kthimin e mjeteve të paguara për stafin që nuk janë zjarrfikës dhe të sigurojë që mos të ndodhin në të ardhmen pagesa që nuk janë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të siguroj që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.
3.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe objektet të cilat nuk janë të regjistruara të regjistrohen sipas kërkesave të rregullores në mënyrë që vlera e pasurive në PFV të jetë e plotë.
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që regjistri i pasurisë të azhurnohet në vazhdimësi në raport me projektet e përfunduara duke i respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë.
5.	Baza për opinion	Ministri duhet të merr masa që në koordinim me akterët përgjegjës të zgjidhen problemet me sistemin E-pasuria në mënyrë që gjendja e pasurisë jo-kapitale të entitetit të prezantohet saktë.
6.	Baza për konkluzion	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të ndërmarrin masa në kthimin e mjeteve për kompensime të pa rregullta dhe të sigurojë që në të ardhmen kompensimet e Sekretarisë së Bordit të AKSP-së të bëhen vetëm mbi bazën e legjislacionit në fuqi.
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që të ketë ndarje adekuate të detyrave në rastet e emërimit të menaxherëve të kontratës në mënyrë që të parandalohet konflikti i interesit.
8.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së të siguroj që në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktohen afatet kohore të kontratave si dhe kontratat publike kornizë të mos tejkalohen.

9.	Baza për konkluzion	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.
10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.
11.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në këtë proces duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar zgjidhjen e kësaj situate.
12.	Baza për konkluzion	Ministri, respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të rishikojnë vendimin për shujta ditore dhe të ndërmarrin masa për ndalimin e tyre nga kategoria mallra dhe shërbime.
13.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.
14.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të sigurojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në raport me KRPP-në duke e njoftuar atë në të gjitha rastet kur kjo kërkesë është obligative.
15.	Investimet kapitale	Ministri duhet të ndërmerr masa konkrete përmes të cilave siguron realizimin e projektit për Spitalin e Prishtinës.
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që LI/A të prezantohen drejtë në RVF.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Florim Beqiri, Udhëheqës i Auditimit



Mehmet Mucaj, Udhëheqës i ekipit



Fjolla Bakalli, Anëtare e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/DATE:	NR. PROT. / NR. PROT.:	NR. PROT. / NR. PROT.:	NR. FOLIOVE / NR. STRANICA:
03	47	1069	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRASNI POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS / CABINET OF THE MINISTER			
NR. PROT. / NR. PROT.:	NR. FOLIOVE / NR. STRANICA:	DATA/DATE:	
0406	1	02.07.2021	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnji Poslova
Ministry of Internal Affairs

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhelal Svecila
 Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Data: 02 korrik 2021, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁸ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Në kontratë e nënshkruar kishte përcaktuar se validiteti i kontratës është deri në nënshkrimin e kontratës tjetër.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.